**“BIJTË E MI!
UNË E MBOLLA FARËN,
JU KUJDESUNI PËR TA UJITUR..!”**

**FAKTORË TË RRËNIMIT
TË SHOQËRISË**

**SHQIPËRIA
“SHTET” UNIKAL NË DIKTATURË**

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 22 - Nr. 8 (258), Gusht, 2024

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Minareja e xhamisë Kutubije, Marekesh - 1158

MYFTIU FALËNDERON PRESIDENTIN E REPUBLIKËS PËR QËNDRIMIN NDAJ FENOMENIT TË MIKROKREDIVE

PËRSE E KA KRIJUAR ZOTI MOSBESIMTARIN DUKE E DITUR SE AI DO TË PËRFUNDOJË NË ZJARR?!

PROMOVOHET LIBRI: “HADITHI: TRASHËGIMIA E PROFETIT MUHAMED” I STUDIUESIT DR. JONATHAN AC BROWN

NJË GRUP STUDENTËSH ITALIANË VIZITOJNË XHAMINË E PARRUCËS

MYFTIU PRITI FAMILJARË TË DIJETARIT, SHEJKH NASURIDIN EL-ALBANI

CHAT GPT DHE INTELIGJENCA ARTIFICIALE

“BIJTË E MI! UNË E MBOLLA FARËN, JU KUJDESUNI PËR TA UJITUR..!”

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe Madhështia absolute i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar, Zotit të Vetëm të gjithësisë. Atë e falënderojmë ditë e natë që na bëri prej muslimanëve.

Të gjitha selamet dhe salavatet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo moment të jetës sonë, më të mirit dhe më të shtrenjtit të krijesave të Allahut, Hz. Muhammedit (a.s), i cili sikurse transmetohet në librat e saktë të hadithit, hyri një ditë në varreza dhe i dha selam banorëve të asaj varreze duke thënë: “Es-selamu alejkum dare kaumin mu’minin”, pra: “Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përmbi ju, o vend i besimtarëve!”, “ve inna inshaallahu bikum lahikun”: “edhe ne inshallah do vijmë pas jush!”

Pastaj Pejgamberi (a.s) tha: “Kisha dëshirë të shoh vëllezërit tanë!” Sahabët u habitën e i thanë: O Resulallah, a nuk jemi ne vëllezërit e tu? – tha: “Ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit tanë janë ata që do të vijnë pas nesh!”

Të dashtun e të shtrenjtë,

Le të ndalemi te kjo fjalë e madhe e Pejgamberit (a.s) dhe ta vendosim veten në pozitën e atyre që Pejgamberi (a.s) ka thënë se janë ***vëllezërit tanë***, pra, vëllezërit e Pejgamberit (a.s), vëllezërit e Hz. Ebu Bekrit, Hz. Omerit me shokë dhe, ta pyesë veten e tij gjithsecili, se a mund të thotë me krenari: unë jam vëllai i Pejgamberit (a.s), unë jam vëllai i Musab ibn Umejrit, unë jam vëllai i Abdurrahman ibn Aufit, unë jam vëllai i..., dhe përmend sa të duash prej emrave më të mëdhenj të historisë së njerëzimit, pas pejgamberëve të Allahut. Kjo do të thotë se Pejgamberi (a.s) na ka lënë një përgjegjësi shumë të madhe dhe një tërheqës vëmendjeje aktiv e të përhershëm, që në çdo moment që mund të rrëshqasë këmba e ndonjërit prej nesh ta çojë mendjen tek ajo fjalë e madhe: ***“Vëllezërit tanë!”***

“Ore, ti je vëllai i Pejgamberit; ore ti je vëllai i Hz. Ebu Bekrit, po ti je vëllai i Hz. Omerit!” dhe thua: ku me e thënë këtë, kur me e thënë? – me e thënë në çdo situatë që përballesh në jetë dhe me e thënë gjithsecili nga pozita, ku e sheh veten vëlla me një prej sahabëve të Pejgamberit (a.s).

Tregtari me Hz. Abdurrahman ibn Aufin; njeriu i sinqertë dhe korrekt me Hz. Ebu Bekrin; njeriu i drejtë dhe që nuk i trembet syri përpara zullumeve me Hz. Omerin; njeriu adhurues e që i lutet Allahut pa ndërprerje dhe që jep dhe është bamirës me Hz. Osmanin; njeriu i drejtë dhe që është vetëflijuar për të drejtën dhe adhurimin dhe besimin me Hz. Aliun, dhe përmend kështu pafund emrat e sahabëve të Pejgamberit (a.s).

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Ka një zamahalli të madhe në të cilën është përfshi mbarë bota sot, ka një prishje të ekuilibrave. Shihni njëlloj hipokrizie të padëshmuar më parë gjithandej nëpër botë, diku thirret me të madhe për të drejtat e një komuniteti të shthurur, diku tjetër vriten njerëz të pafajshëm në lufta të padrejta dhe të gjithë heshtin. Atje vriten me qindra gazetarë të pafajshëm që transmetojnë ditë natë një ndër zullumet më të mëdha të historisë së njerëzimit dhe askush nuk flet! Domethënë, janë prish ekuilibrat e drejtësisë. Domethënë, është përfshi dhe është përhap hipokrizia më zi se zjarret e Shëngjinit e përreth Shkodrës, por jo vetëm, në këto ditë vere!

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Allahu (xh.sh) na nxit në Kur’anin Famëlartë duke iu drejtuar Pejgamberit (a.s), një ajet kur’anor që duhet të jetë adresë e gjithsecilit prej nesh dhe pikë referimi në çdo frymë që merr: “Prandaj ti kapu fort pas asaj që të shpallet, se me të vërtetë ti je në rrugë të drejtë!” - (Kur'ani, Ez-Zukhruf: 43)

Nëse ty ta drejtojnë gishtin dhe të thonë: *Ti je i pamëshirshëm, ti je i paditur, ti je katil, ti je i prapambetur, ti je, ti je..!* Ti i mbyll sytë dhe thua: Allahu (xh.sh) i drejtohet Pejgamberit (a.s) (që na konsideronte vëllezër) dhe i thotë: “Kapu fort pas asaj që të shpallet!”, “Sepse ti je në rrugë të drejt!”

Nëse Allahu (xh.sh) të thotë, se ti je në rrugë të drejtë, le të ngrihet krejt bota, prej më të madhit në dukje e deri tek më i papërfillshmi në dukje, dhe le të thotë se ti nuk je në rrugë të drejtë!?

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Në rrugën e dështimit të kësaj feje të madhërueshme islame, në rrugën e dështimit të vlerave të këtij Islami të mrekullueshëm, gjithsecili prej nesh duhet të çojë ndër mend një fakt shumë të rëndësishëm. Nuk është kusht që unë me e mbjellë dhe unë me hëngër frutat?! Kemi qenë studentë tek një prej dijetarëve më të mëdhenj të këtij shekulli, në Damask të Sirisë, tek hoxha i jonë, Shejkh Ahmed Keftari, rahmet pastë. Në moshë të thyer diku pas nëntëdhjetave, i kërrusur, shumë i lodhur nga aktiviteti i pambarimtë i tij, me mjekër të bardhë, me një zë që mezi i delte, tha një ditë: “Bijtë e mi, gjatë këtyre 80 viteve a më

> “Allahu (xh.sh) na nxit në Kur’anin Famëlartë duke iu drejtuar Pejgamberit (a.s), një ajet kur’anor që duhet të jetë adresë e gjithsecilit prej nesh dhe pikë referimi në çdo frymë që merr: “Prandaj ti kapu fort pas asaj që të shpallet, se me të vërtetë ti je në rrugë të drejtë!”

tepër, unë jam përpjekur që të mbjell një farë të mirë, lutem dhe shpresoj që pas meje kujdesuni për ta ujitur, për ta mirëmbajtur atë, që dikush pas jush të ushqehet nga frutat e saj!”

Atë çfarë ne punojmë sot, nuk është kusht t’i shohim frutat e saj, prandaj mos me u ngut dhe me e shiju Islamin natyrshëm, krejt si rrjedhat e lumenjve me të cilat na ka begatuar Allahu (xh.sh); natyrshëm. Sepse nuk është kusht që ne me marrë frutat e asaj se çfarë punojmë e veprojmë në këtë botë sa jemi gjallë.

Ne marrëdhënien e kemi me Allahun e jo me robin e Allahut! Me robin e Allahut duhet të jemi sa më të drejtë, sa më të mëshirshëm, sa më bashkëpunues, sa më solidar, por jo për të, për hir të Allahut!

Për fund, a e keni pyet veten ndonjë ditë, se a e ka shijuar madhështinë e Islamit dhe triumfin e tij, fjala bie, Hz. Hamza ose Hz. Musab ibn Umejri, të cilët ranë shehidë në ditën e Uhudit, a e kanë parë ato çlirimin e Mekës? Jo. Po para tyre Hz. Jasiri edhe e shoqja, Sumeja, Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve, dy shehidët e parë në Islam, a e kanë dëshmuar përfundimin e shpalljes së Kur'anit?

A e kanë dëshmuar Bedrin, Uhudin, Hunejnin, Hixhretet, Paktin e Hudejbijes, etj, etj? Jo. Pyeteni veten, nëna jonë e madhe, e papërsëritshmja Hz.Hatixhe Kubraja a e ka dëshmuar çlirimin e Mekës? A ka qenë përbri të shoqit, në ditën kur hynte me krye të ulur në shenjë falënderimi ndaj Allahut (xh.sh), në atë vend, njerëzit e të cilit e kishin nxjerr jashtë dhe do ta vrisnin, hynte triumfues, a e dëshmoi nëna e jonë atë ditë, atë gëzim të madh për muslimanët?! Jo, por Pejgamberi (a.s) shkoi dhe vendosi flamurin e triumfit tek varri i saj, madje e vendosi çadrën e tij drejt varrit të saj për të na thënë se zinxhiri i njerëzve të përkushtuar për këtë Islam dhe lidhja me të parët është obligim te ne!

Mirëpo, ata që kanë kaluar kanë ngelur shenjë e mirë ndër ne, edhe pse nuk e dëshmuan të sotmen. Ne duke e kujtuar gjithsecilin prej tyre, sikur i themi: Ti je me mua! Kjo rrugë dhe ky zhvillim, nuk njeh individ të përvetshëm, por njeh frymën e zhvillimit, frymën e përkushtimit për hir të Allahut (xh.sh)!

Pyeteni veten, a e dëshmoi Hz. Ebu Bekri zhvillimin e madh të Islamit në kohën e Hz. Omerit? Jo! A e dëshmoi Hz. Omeri zhvillimin e madh të Islamit në Andaluzi? Jo! Mirëpo, kur përmendet zhvillimi e përmendet më e mira në Islam, gjithsecili prej këtyre emrave është një gur i çmuar në një mozaik të papërsëritshëm, prandaj vendose veten tënde aty ku të ka lënë Zoti dhe dëshmoje veten të aftë për atë çfarë Allahu (xh.sh) do prej teje, aty ku të ka vendosur në jetë!

Për fund, ditën e djeshme isha për një vizitë tek Presidenti i Republikës, në një takim të përbashkët me Zotninë e tij. E kam falënderuar përzemërsisht për qëndrimin e Tij shumë fisnik, njerëzor dhe logjik në lidhje me përhapjen e fenomenit të mikrokredive!? E dini dhe mund të keni dëgjuar se sa e sa njerëz janë prekur nga kjo e “mirë” gjoja; që po të jap diçka për të të nxjerrë nga bataku ku ke rënë, pastaj paguaj e paguaj e ndoshta mbetesh peng i asaj çfarë ke marrë e të prishet jeta, të shkatërrohet jeta siç i është prishur e shkatërruar shumëkujt tek ne!

Sepse, Allahu (xh.sh) sikurse thoshte hoxha jonë i madh, ekonomisti islam më i madh i këtij shekulli, Myfti Takijudin Osmani, Allahu e nderoftë dhe i dhëntë jetë të gjatë, e shëndet të plotë; më tha një ditë kur e pyeta për fetvatë, që dalin nga ata që legjitimojnë marrjen e kredive, më tha: Ku t’i çoj unë ajetet që flasin për luftën e Allahut dhe Pejgamberit të Tij ndaj atyre, që zhyten në detin dhe llumin e kamatës dhe haramit, ku ti çoj ajetet?!

Prandaj, të dashur dhe të shtrenjtë, thirrja e Presidentit të Republikës sonë është thirrja e logjikës së pastër të zhvillimit të jetës me ndershmëri dhe mos përfitimit të dikujt në kurrizin e dikujt tjetër.

Mirëpo, karshi kësaj dhe përtej asaj, çfarë mund të bëjnë institucionet e vendit tonë për të shëruar këtë plagë të dhimbshme të shoqërisë sonë? Lypset, që institucionet tona islame dhe mendjet e ndritura, të mendojnë për ngritjen e një Fondi Islam për Zhvillimin, të mendojnë për ngritjen e një Fondi Islam për njerëzit në nevojë, sepse ka shumë njerëz të cilët mezi kalojnë muajin, ka të sëmurë që mezi blejnë ilaçet e përmuajshme; pa le pastaj po t’i qasemi operacioneve apo ndërhyrjeve të frikshme për sa i përket çmimeve që dëgjojmë e shikojmë në realitetet e sotshme! Detyra jonë është të mendojmë t’i ofrojmë njerëzve zgjidhje, jo thjeshtë të miratojmë e të konstatojmë e duke thënë faleminderit për dikë që me të drejtë e çon zërin aty ku duhet dhe në momentin kur duhet.

Allahut (xh.sh) i lutem të na begatojë dhe të na japë më të mirën në këtë botë e të na bëjë të jetojmë si vëllezër të Pejgamberit dhe sahabëve të tij, e të na bëjë të punojmë në atë mënyrë që ata që vijnë pas nesh të thonë rahmet paçin baballarët tanë, sa burra të mirë dhe sa besimtarë të përkushtueshëm që ishin, dhanë çdo gjë që kishin për fenë e Allahut dhe punuan me sa kishin për fenë e Allahut dhe nuk u kursyen me sa patën mundësi për fenë e Allahut. Allahu ju dashtë e ju begatoftë!

(Hytbeja e xhumasë e mbajtur në xhaminë e Bardhajve, më 2 gusht 2024)

H. Vehbi S. Gavoçi
(1923 - 2013)

> “Falja e namazit dhe porositë e tjera fetare formojnë folenë e më vonë edhe kullën e mirësjelljes, formojnë karakterin që e ruajnë njeriun njëlloj si e ruan ai veten nga e keqja.
>
> Falja e namazit është nevojë e madhe për jetën e ardhshme në të cilën secili njeri korr atë çfarë ka mbjellë në këtë jetë, e cila është shumë e shkurtër në krahasim me atë që është e përhershme!”

(Nga libri: Shtyllat e Islamit – Namazi)

FAKTORË TË RRËNIMIT TË SHOQËRISË

Naim Drijaj
Imam - xhamia, Parrucë

Në një hadith të transmetuar nga Muslimi, Pejgamberi (a.s) përmend disa vepra të shëmtuara e shkatërruese që nëse përhapen në një shoqëri ato e shkatërrojnë atë. Pejgamberi (a.s) thotë: "Ruhuni nga padrejtësia, pasi padrejtësia është errësirë në ditën e kiametit". Me fjalën "Edh-Dhulm" (Padrejtësi) nënkuptohet: "Kalimi i kufijve të përcaktuar nga Allahu, pa marrë parasysh formën dhe mënyrën!"

Allahu i Madhëruar thotë: "Kush del jashtë ligjeve të Allahut, e ka dëmtuar rëndë vetveten!" Kuptimi thelbësor i fjalës "Edh-Dhulm" është: Të vendosësh diçka në vendin e gabuar dhe aty ku nuk duhet.

Njeriu bën padrejtësi:

1. Kur mashtrohet nga forca e tij dhe e llogarit tjetrin të dobët: Allahu (xh.sh) thotë: "A mendon njeriu se askush s'ka fuqi mbi të?"

2. Kur sigurohet se nuk ka mbikëqyrës e as dënim për të: Allahu i Madhëruar thotë: "A mendon njeriu se nuk e ka parë askush?"

Padrejtësia ndahet në disa lloje dhe padrejtësia më e madhe është padrejtësia në raport me Allahun duke e mohuar Atë, duke i shoqëruar shok Atij në adhurim, duke mos e falënderuar Atë për begatitë e mirësitë që na ka dhuruar dhe duke mos iu bindur e nënshtruar Atij. Pejgamberi (a.s) është pyetur: "Cili është gjynahu më i madh?" Ai ka thënë: "T'i bësh ortak Allahut, ndërsa Ai të ka krijuar!" Çdo formë e rebelimit dhe mëkatimit në raport me Allahun është padrejtësi. Sot padrejtësia është përhapur në masë të madhe dhe ka marr forma të ndryshme të veprimit e manifestimit në jetën e përditshme të njerëzve.

Gjithashtu i Dërguari i Allahut (a.s) na tërheq vëmendjen nga rreziku i koprracisë me fjalët: "Ruhuni nga lakmia e vetvetes (koprracia), pasi ajo i ka shkatërruar ata që ishin para jush, i ka bërë që të vrasin njerëzit dhe të përdhosin shenjtëritë e tyre (duke lejuar të ndaluarën)!"

Në këtë hadith Pejgamberi (a.s) ka përmendur fjalën "Esh-Shuhh" që në gjuhen tonë përkthehet lakmi, por nuk është vetëm koprracia sepse koprracia ndahet në disa kategori. Atë kategori që Pejgamberi (a.s) ka përmendur në këtë hadith është kategoria më e keqe e koprracisë ku është e kombinuar dhe e shoqëruar me pangopësi dhe lakmi.

Njeriu është koprrac dhe dorështrënguar në atë që ka dhe lakmitar në atë që të tjerët kanë. Koprracia me të gjitha format, simptomat dhe manifestimet e saj është e përbuzur dhe e përçmuar. Allahu i Madhëruar sqaron në Kur'anin Famëlartë, se kush e pastron veten nga lakmia e vetes (koprracia) është i shpëtuar: "Kush i ruhet koprracisë së vetes, është i shpëtuar!" Ebu Hejaxh Esediu tregon: "Kur po bëja tavafin rreth Qabes, pashë një burrë, i cili po lutej me fjalët: "O Allah! Më ruaj nga lakmia e vetes!" Ai lutej vetëm me këto fjalë dhe nuk thoshte asgjë tjetër. Unë e pyeta, se përse e bënte këtë lutje. Ai m'u përgjigj: "Nëse ruhem nga lakmia e vetes time, unë nuk vjedh, nuk bëj imoralitet dhe nuk bëj asgjë tjetër të ndaluar!" Pasi e pashë me vëmendje, e njoha atë. Ai ishte Abdurrahman ibn Aufi (r.a)" .

Çfarë përfitojmë nga ky hadith?

1. Fillimisht kur Pejgamberi (a.s) thotë: Ruhuni nga këto rreziqe sepse këto janë shkatërruese, na jep të kuptojmë se njeriu në këtë botë është i ekspozuar nga rreziqe të ndryshme dhe na mëson se nga t'i kthejmë sytë, cilët kufi të mbrojmë dhe nga mund të na vijë rreziku e shkatërrimi. Njerëzit në përgjithësi janë të prirë që të shikojnë rreziqet e jashtme, pra armikun e jashtëm dhe harrojnë se mund ta rrezikojnë vetën e tyre nga vetë vetja e tyre (pra nga brenda).

Sot fatkeqësisht po shohim se në aspektin global ajo që më së shumti po e rrezikon njeriun është vetë njeriu. Pejgamberi (a.s) na ka kështilluar që të kthehemi tek vetvetja jonë. Nëse ne e largojmë padrejtësinë nga shoqëria jonë, nga familjet tona, nëse në jemi dorëdhënës dhe bujarë largojmë koprracinë dhe veset e këqija, me lejen e Zotit kështjellën e kemi të fortë dhe të mbrojtur nga brenda. Kur kështjella është e fortë nga brenda dhe e fortifikuar mirë goditjet e jashtme nuk kanë mundësi ta rrënojnë atë asnjëherë.

2. Në këtë hadith Pejgamberi (a.s) ka përmendur fjalën "Esh-Shuhh" që në gjuhen tonë përkthehet lakmi (koprraci). Koprracia në këtë rast nuk ka të bëjë vetëm me pasurinë por edhe me të drejtat që kemi ndaj të tjerëve.

Njeriu më shumë mund të jetë koprrac në mentalitet sesa në xhep. Çfarë do të thotë të jesh koprrac në mentalitet? Të jesh koprrac në mentalitet do të thotë që gjithmonë pret që të tjerët t'i kryejnë obligimet ndaj teje, i fajëson ata dhe asnjëherë nuk shikon veten. Atëherë kur t'i kryejmë obligimet që kemi ndaj njëri-tjetrit do të garantohet drejtësia.

3. Gjithashtu Pejgamberi (a.s) në këtë hadith thotë që ka disa vese në shoqëri që ne nuk i kushtojmë shumë vëmendje por ato janë më shkatërruese sesa tërmeti, vullkani, pandemia, varfëria etj.

4. Pejgamberi (a.s) tha: Ruhuni nga padrejtësia, nga koprracia ngase ato shpien në shkatërrim, në vrasje, në tejkalim kufijsh e kështu me radhë. Pra e keqja fillon e vogël, pastaj bëhet e madhe, prandaj nuk duhet të neglizhojmë asnjë të keqe.

5. Dy gjëra janë shkatërruese, të cilat i shkatërruan edhe ata që ishin para nesh. Pejgamberi (a.s) ka thënë: E para: "Vrasja e njerëzve për gjëra të rëndomta e të thjeshta". Në një shoqëri ku nuk është i shenjtë gjaku i njeriut dhe nuk ka vlerë jeta e tij, ajo shoqëri është drejt shkatërrimit.

Në Haxhin e Lamtumirës, i Dërguari i Allahut (bekimet e Allahut qofshin mbi të) shpalosi solemnisht dhe mori në mbrojtje të drejtat e njeriut, duke e konsideruar njeriun si qenia më fisnike, që meriton nderim dhe respekt. Ndër të tjera, ai theksoi: "Me të vërtetë që gjaku, pasuria dhe nderi juaj janë të shenjtë, siç është e shenjtë kjo ditë, ky muaj dhe ky vend!" Nëse këto parime respektohen ka të ardhme.

E dyta: "I shkelnin kufijtë, pra për ta nuk ishte haram asgjë". Në një shoqëri që çdo gjë është hallall dhe për ta nuk ka haram, ajo shoqëri është shoqëri e shthurur dhe e shkatërruar.

Allahu na ruajt nga çdo dukuri e shëmtuar e negative që rrezikon shoqërinë, neve dhe familjet tona. Allahu na bëftë mbrojtës të vlerave të atyre që na ka mësuar Allahu dhe Pejgamberi (a.s). Zoti na ruajt nga çdo fushatë dashakeqëse e cila rrezikon të ardhmen e familjeve dhe fëmijëve tanë!

MYFTIU FALËNDERON PRESIDENTIN E REPUBLIKËS PËR QËNDRIMIN NDAJ FENOMENIT TË MIKROKREDIVE

Gjatë hytbes së xhumasë të mbajtur, më datë 2 gusht 2024, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ndër të tjera shprehu edhe falënderimin e tij për presidentin e Republikës, Sh.T.Z. Bajram Begaj, për thirrjen e tij drejtuar parlamentit në lidhje me fenomenin e mikrokredive.

Ndër të tjera, Myftiu tha: "Ditën e djeshme, isha për vizitë te Presidenti i Republikës, në një takim të përbashkët me Zotërinë e tij, ku e falënderova përzemërsisht për qëndrimin e Tij shumë fisnik, njerëzor dhe logjik, në lidhje me përhapjen e fenomenit të mikrokredive.

E dini dhe mund të keni dëgjuar, se sa e sa njerëz janë prekur nga kjo "e mirë" gjoja, për të të dhënë diçka për të nxjerrë nga bataku ku ke rënë, pastaj paguaj e paguaj, e ndoshta mbetesh peng i asaj që ke marrë duke t'u prishur e shkatërruar jeta, siç i është prishur dhe shkatërruar shumëkujt!

Hoxha i jonë dhe ekonomisti më i madh islam i këtij shekulli, Myfti Tekijudin Osmani, Allahu e nderoftë dhe i dhashtë jetë të gjatë e shëndet të plotë, më tha një ditë, kur e pyeta për fetvatë, që dalin për legjitimimin e marrjes së kredive; më tha: "E ku t'i çoj unë ajetet, që flasin për luftën e Allahut dhe të Pejgamberit të tij, ndaj atyre që zhyten në detin dhe llumin e kamatës dhe haramit; ku t'i çoj ajetet?!"

Prandaj, të dashur dhe të shtrenjtë, thirrja e presidentit të Republikës sonë, është thirrja e logjikës së pastër të zhvillimit të jetës me ndershmëri dhe mospërfitimit të dikujt në kurrizin e dikujt tjetër!

Mirëpo, karshi kësaj dhe përtej asaj, që mund të bëjnë institucionet e vendit tonë për të shëruar këtë plagë të dhimbshme të shoqërisë tonë, lypset që institucionet tona islame dhe mendjet e ndritura muslimane të këtij vendi, të mendojnë për ngritjen e një Fondi Islam për Zhvillimin. Të mendojnë për ngritjen e një fondi islam për njerëzit në nevojë, sepse ka shumë njerëz, të cilët mezi kalojnë muajin; ka të sëmurë, që me vështirësi blejnë ilaçet e përmuajshme; pa le pastaj, po t'i qasemi operacioneve apo ndërhyrjeve të frikshme përsa i përket çmimeve, që dëgjojmë dhe shohim në realitetet e sotme shqiptare.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari gjatë takimit me Presidentin e Republikës, Sh.T.Z. Bajram Begaj

Detyra jonë është të mendojmë për t'i ofruar njerëzve zgjidhje, jo thjeshtë duke miratuar dhe konstatuar, apo me falënderime për dikë, që me të drejtë e çon zërin aty ku duhet dhe në momentin kur duhet!"

SHPESH E KAM MENDUAR...

-Në vend të parathënies-

Xhahid Bushati - *Shkrimtar*

Shpesh e kam menduar... A jetojnë arkivat? Po shtëpitë-muze, a janë ngritur? Po librat që ata të Diturit kanë shkruar, ku janë e ku mund të jenë? Apo...

Shpesh e kam menduar... E kam menduar gjatë... Duke udhëtuar në vitet e moshës dhe të kohës sime, a do të jem në gjendje të gjurmoj e sadopak të njoh rrugëtimin dhe Dritën e Madhënueshme të të tjerëve, në kohë të tjera, në realitete të tjera, në dekada e shekuj të tjerë të Ylemave shkodranë shumë të dashtun e të shtrenjtë të mi, si: hoxhallarë, mësues-myderrizë, imamë, vaizë, myezinë... të njohur e të panjohur që adhuruan Allahun, iu falën atij, duke u bërë modele të besimit mysliman; ku modele të tilla ndritën kohën që jetuan, kapërcyen kohën dhe përsëri ndritën edhe më fuqishëm, e më fuqishëm do të ndrijnë në të ardhmen, sepse përsëri është KOHA e tyre. E, arsyeja është shumë e thjeshtë: - Mbeten Kujtesë historike jetë e mot. Modele referimi. Qofshin përherë të Xhennetit, ata që kanë ndërruar jetë! Ndërsa, ata që jetojnë: - Paçin mbarësi në Misionin e tyre fisnik për pastrimin e zemrave nga negativiteti i kohës, duke i mbushur ato zemra me Dritën e Zotit, ku lumturia familjare e ajo shoqërore fjalën 'E SIGURT' e ka buzëqeshje Ardhmërie.

Shpesh e kam menduar... Po jeta e tyre e vlertë, në cilat kujtime rri? A janë shkruar? Mos kanë humbur? A përmenden më? Duhen gjurmuar, që të mos ketë një vdekje të dytë...

Shpesh e kam menduar... Po fotot e tyre, a gjenden? Nuk i kanë ruajtur? Mos kanë humbur? Mos janë grisur? Mos janë harruar? Mos janë bërë të largët, kur duhen të jenë të afërt, e mes nesh, ende, në rolin e Dijetarit, Edukatorit e të Mësuesit? A ka menduar dikush për albume, për konferenca, për ekspozita, përkujtimore, emisione në radio a në televizion... etj.? Se u duhej dhënë Ylemave përjetësia! Brezat që jetojnë e brezat që vijnë, në mes të tjerave Kohës duhet t'i flasin përmes figurave të ndritura, që sigurisht, kanë bërë epokë, kanë lanë amanete, kanë lënë dëshmi të patjetërsueshme edhe në kohë të vështira, edhe në kohë me diell, me shi, me vranësira, me furtura e tramundana, me vetëtima e bubullima...etj.; edhe kur e kanë ditur që femohuesit i kanë urryer, vrarë dhe zhdukur... Ata kanë qëndruar me kokën lart, duke kënduar një ilahi, duke përmendur një urti hadithi, duke puthur tespijet...

Shpesh e kam menduar... A jetojnë arkivat? Po shtëpitë-muze, a janë ngritur? Po librat që ata të Diturit kanë shkruar, ku janë e ku mund të jenë? Apo...

Shpesh e kam menduar dhe shumëçka kam menduar... Mendoj që i takon Komunitetin Mysliman, të përgatisë studiues që të hulumtojnë, veçanërisht në arkivat turke, e të gjejnë reliket e xhevahiret e dijetarëve myslimanë, në rastin tonë që po marrim në shqyrtim: Shkodranë.

Shpesh e kam menduar... Përmes këtij libri-ese që sapo kam nisur do të udhëtoj e do të hedh rreze drite sadopak njohjeje për ata që nuk duhen harruar. Unë dua t'i krahasoj me DRITËN. Më thoni, ju lutem, - Kush nuk e do Dritën e Vërtetë?

Fillimi i një procesi pune për librin-ese me titull: "Rrugëtimi i Ylemave shkodranë - dimension drite, urtie dhe i KUJTESËS HISTORIKE."

PËRSE E KA KRIJUAR ZOTI MOSBESIMTARIN DUKE E DITUR SE AI DO TË PËRFUNDOJË NË ZJARR?!

Durim Kasemi
Imam - xhamia, Parrucë

Kjo pyetje shtrohet në forma ta ndryshme, por që të gjitha sillen rreth një boshti i cili është: Nëse Allahu është i Gjithëditur për çdo gjë para se të ndodhë, krijimi i mosbesimtarit duke e ditur se ai do të përfundojë në zjarr, detyrimisht nënkupton mangësi të Zotit, sepse krijimi i dikujt që e di se do të përfundojë në ndëshkim, tregon mungesë mëshire krejtësisht!?

Gjithashtu krijimi i mosbesimtarit tregon për mungesën e drejtësisë së Zotit, sepse Zoti po dënon një njeri i cili nuk mund të dalë përtej caktimit të Tij!

Kjo kundërshti, është ndër më të shpeshtat e më të përsëriturat prej ateistëve e kritikëve të fesë.

Fillimisht, këtu kemi dy gabime. I pari është se është keqkuptuar natyra e përsosmërisë hyjnore të Zotit, siç e besojnë muslimanët. Së dyti, njerëzit këtu i kanë përcaktuar vetës së tyre disa kritere të caktuara të përsosmërisë lidhur me cilësinë e mëshirës dhe drejtësisë, e pastaj kanë gjykuar veprimet e Zotit bazuar në këto kritere. Kur veprimet e Zotit nuk përputhen me kriteret e vendosura prej tyre, atëherë gishtat drejtohet drejt e ekzistencës së Zotit dhe përsosmërisë së Tij.

Nuk bie në kundërshtim me përsosmërinë hyjnore në mëshirë, sepse mëshira është cilësi prej cilësive të veprimit siç janë falja, bujaria dhe fshirja e gjynaheve, etj. Cilësitë e veprimit nuk janë përsosmëri vetëm nëse shoqërohen me urtësinë. Me kuptimin: vendosjen e çdo gjëje në vendin e saj të duhur, si dhe me drejtësinë, me kuptimin: dhënien e asaj që i takon çdo gjëje.

Cilësitë e veprimit nuk mund të kuptohen pa këto dy elementë. Falja nuk mund të konsiderohet përsosmëri vetëm nëse shoqërohet me urtësinë dhe drejtësinë. Për këtë, falja ndaj kokëfortit, mendjemadhit, shkelësit të të drejtave të të tjerëve nuk është përsosmëri. Nuk është përsosmëri vetëm nëse vendoset në vendin e saj të përshtatshëm, si falja për gabimtarin e penduar, apo të paditurin harrestarë e të ngjashëm me to.

Nëse Zoti nuk falë dikë, sepse nuk e meriton faljen, kjo nuk është e metë por është vetë përsosmëria.

Por, kundërshtarët e krijimit të mosbesimtarit e kanë hedhur tej këtë të vërtetë dhe e kanë trajtuar cilësinë e mëshirës të shkëputur nga lidhshmëria që ka me drejtësinë dhe urtësinë. Ata kanë menduar se përsosmëria e mëshirës hyjnore do të thotë të përfshijë çdo gjë pa përjashtim, pa dallim mes njerëzve, pa dallim mes atij që e meriton mëshirën dhe atij që nuk e Meriton atë. Nisur nga kjo ata kanë parë se Zoti nuk e ka mëshiruar mosbesimtarin duke e futur atë në zjarr dhe kjo bie ndesh me përsosmërinë hyjnore në mëshirë.

Sikur këta ta vërtetonin se mosbesimtari e meriton mëshirën e pastaj të kundërshtonin përsosmërinë e mëshirës hyjnore do të ishin në rregull, por nuk kanë vepruan kështu.

Ndërsa lidhur me kundërshtinë mes drejtësisë Zotit dhe krijimit të mosbesimtarit themi se: Zoti e ka fshehur prej njerëzve dijen e Tij të mëparshme për çdo gjë. Askush nuk mund ta dijë se çfarë ka caktuar Zoti e çfarë ka dashur.

Pas kësaj, Allahu e ka krijuar njeriun në atë formë që mund t'i zgjedhë veprimet e tij, e të përcaktojë sjelljen e Tij me vullnetin dhe aftësinë që ka. Çdo njeri posedon aftësinë për të ndikuar në veprimet dhe sjelljen e tij, dhe kjo është diçka e njohur për çdo kënd, nuk mund të mohohet assesi!

Edhe përzgjedhja e mosbesimtarit të veprimeve të tij, nuk është jashtë kësaj të vërtete të pakundërshtueshme. Ai ka aftësi dhe vullnet siç ka edhe besimtari. Dija e Zotit është e fshehur për të dy grupet, besimtarët dhe jobesimtarët. Të dyja grupet janë urdhëruar për të mirë dhe janë ndaluar nga e keqja në mënyrë të barabartë e të qartë, por përzgjedhja e tyre ka qenë e ndryshme, me vullnetin dhe zgjedhjen e tyre të lirë.

Dallimi mes tyre nuk buron vetëm nga dija e Zotit, por edhe nga vetë vendimi i tyre. Dija e Zotit është e përparshme dhe jo imponuese. Të dy këta kur bëjnë veprimet nuk dinë asgjë për dijen e Zotit por kanë vepruar secili bazuar në çka ndjejnë brenda vetes së tyre në bazë të vullnetit dhe dëshirës.

Këtu duhet shtuar edhe diçka se Allahu nuk e ka krijuar mosbesimtarin, mosbesimtar që nga lindja e tij, por e ka krijuar me natyrë të pastër që nënkupton gatishmërinë e tij e tij për të besuar, pa dallim nga besimtari, por mosbesimtari ndryshon se ai zgjedh devijimin nga besimi.

Kundërshtarët e besimit në Zot, janë hutuar nga këto kuptime e parime, duke imagjinuar se Zoti e ka veçuar besimtarin me disa dhunti, ndërsa mosbesimtarin e ka privuar prej tyre.

Krijimi i mosbesimtarit nuk bie ndesh me urtësinë e Zotit. Për të argumentuar këtë duhet të rikujtojmë se urtësia e Zotit është e paarritshme nga mendja njerëzore. Njerëzit në raport me të janë ose: krejtësisht të paditur, ose mund të kenë pak njohuri rreth saj ose, bazuar në aftësitë mendore të tyre ose tek ndonjë gjë të zbuluar prej Zotit.

Nëse njeriu nuk gjen ndonjë urtësi tek krijimi i mosbesimtarit, duhet të pranojë pamundësinë dhe paaftësinë e tij. Nuk është e logjikshme që të mohojnë krejtësisht urtësinë, apo të dyshojë në ekzistencën e Zotit apo përsosmërinë Tij.



SHQIPËRIA – "SHTET" UNIKAL NË DIKTATURË

Prof. Dr. Bajram Xhafa - *Historian*

Lëvizjet e stuhishme të Dhjetorit 1990 në Shkodër, Tiranë, Kavajë e në gjithë vendin shënuan fillimet e një Revolucioni Demokratik Antikomunist në Shqipëri, lëvizje të cilat më parë kishin përfshirë vrullshëm vendet ish komuniste të Evropës Qendrore e Lindore (vende revizioniste i quante propaganda zyrtare shqiptare atëbotë) që çuan deri në ekzekutim diktatorësh. Fundi tragjik i Çausheskut, kreut komunist të Rumanisë në dhjetor 1989, ishte shembulli më i bujshëm. E gjithë kjo periudhë revolucionesh demokratike që shënuan rënien e diktaturave totalitare komuniste dhe kalimin e këtyre vendeve në sistemin politik shumëpartiak (pluralizëm politik), në mënyrë figurative e me gjuhë gazetareske u quajt "Wind of Change" ("Era e Ndryshimeve"), një eufemizëm për të fshehur fjalën e frikshme "revolucion", një revolucion i ri, në kahe të kundërt me Revolucionin Bolshevik, thelbi i të cilit, siç tregoi ecuria e ngjarjeve mbi 30 vjeçare, vuri në dyshim saktësinë e këtij termi.

Shqipëria nuk mund të bënte përjashtim edhe pse udhëheqja komuniste e saj përpiqej ta trembë ndryshimin e frikshëm me parullën: "Shqipëria nuk është as Lindje, as Perëndim". Por Shqipëria, më e izoluara, unikale edhe në izolim, mbeti e vonuar, si gjithmonë; "nolens-volens" (dashje pa dashje) … "rast i veçantë" (!). Xhindër të fuqishëm të politikës kontinentale e rajonale e mbanin të mbërthyer fort pas kthetrave të "status – quo – së" politike të izolimit dhe diktaturës, ashtu siç mbahej 100 vjet më parë Perandoria Osmane, pjesë e së cilës ishte edhe Shqipëria.

Propaganda komuniste vazhdonte avazin e kahershëm të rrugës krejt të "veçantë" të Shqipërisë socialiste, kuptohet, marksiste – leniniste e vërtetë (siç), për "sukseset" e ndërtimit të socializmit të "vërtetë" edhe në një vend të vetëm, (siç paskesh provuar Lenini për rastin e Rusisë, ndryshe nga ç'farë kishte thënë dikur Marksi), e të një vendi të vogël, (siç "provoi" Enveri për rastin e Shqipërisë). Për ironi, ndërsa sistemi socialist M – L dhe ai revizionist botërisht morën theqafjen, udhëheqja komuniste shqiptare iu rikthye edhe njëherë apelacionit, tezës thuajse të harruar të "epërsisë" së sistemit tonë (socialist) mbi atë kapitalist. Edhe në kushtet e agonisë së tij, botës i bëhej thirrja donkishoteske që të ecte në rrugën që kishte zgjedhur Shqipëria e Enverit. E kishte me të vërtetë apo ishte një kod i ndërsjelltë komunikimi politik ose konfirmim i ndonjë marrëveshjeje, verbale apo e shkruar? Sepse me fatet e Shqipërisë më së shumti është vepruar, ose duhet të jetë vepruar me marrëveshtje verbale, si në tregtinë informale.

"Çuditej" bota apo bënte sikur çuditej me të ashtuquajturën "mrekullia shqiptare". Aty nga vitet '70 të shek. XX, kur rrethi i izolimit u zvogëlua dhe u bë gati hermetik, nga lindja e nga perëndimi, nga të huajt u krijua zhargoni: fenomeni shqiptar, një togfjalësh të cilin propaganda zyrtare e frynte dhe e lançonte (hidhte në qarkullim), nëse nuk e kishte krijuar vetë dhe shpërndarë pastaj nëpër etér. Ishte një mënyorë finoke dhe e poshtër për të "ushqyer" shqiptarët me lugë boshe e për të mbuluar mizerjen.

U krijua stereotipi propagandistik se Shqipëria e socializmit të "vërtetë"(!) të Enver Hoxhës ishte modeli ideal i zhvillimit të shoqërisë njerëzore, si vendi më me pak probleme e më me pak kontradikta. Shqipëria (Londineze): një vend i veçantë e krejt original; unikal në llojin e vetë. Me gjithë problemet e mëdha, Shqipëria heshtte për të drejtat e saj. Ndonëse e kërrusur mizorisht në varfëri ekstreme, robtohej në përvujtninë "krenare" dhe izolimin e saj duke u sakrifikuar e vetsakrifikuar në altruizmin e mazohizmin e saj shembullor, për rendin politik evropian, për "paqen", për "ekuilibrat" evropiane e ballkanike. Asnjë kërkesë politike zyrtare për të drejtat e saj kombëtare, politike dhe ekonomike, njerëzore e demokratike.

Në "epokën socialiste" të Enver Hoxhës, Shqipëria vërtet ishte unikale; unikale në sensin e kundërt të zhvillimit normal: si vendi me problemet më të mëdha kombëtare; si vendi ku shtypja dhe shfrytëzimi i njeriut ishte më e egër se kudo gjetkë në botë, me problemet më të shumta e më të mëdha; si vendi me kontradiktat më të thella e më të ngatërruara, ku çdo fjalë e lëshuar për të drejtat kombëtare a demokratike ndëshkohej "in exktremis".

Në prag të rënies së sistemit, para popullit të vet diktatura kishte krijuar iluzionin e një kalaje të pamposhtur që nuk kishte forcë ta thyente dhe se populli ishte "njësh" me të. Por, sapo u dha krisja e parë, populli i bërë "njësh" me partinë e tij u shpërnda si truma e zogjve kur u bie skifteri. Kur u hap kutia e Pandorës, gjithë vneri dhe qelbi i akumuluar e i ndrydhur nga shtypja ndër vite plasi në formën e një erupsioni vullkanik. Kur mbërrini në terminalin e fundit të

Shqipëria socialiste – shteti i parë dhe i vetmi shtet ateist në botë. Gjë e paimagjinueshme, "novacion" çmendurak, një bidat i paparë e i pangjarë në historinë njerëzore. Partia e Punës e Shqipërisë kishte ngritur edhe një "Muze Ateist" në Shkodër, në qendrën e "reaksionit", siç thuhej nën zë e mbi zë; rast unikal në botë.

saj, Shqipërisë enveriste do t'i shkonte shumë aforizma: *Desha ta la derë e kala(!), / E lashë derë e belá* (Dibër). Një belá virulente, e programuar me saktësi e që vazhdon të pjellë belara të tjera pa fund për një periudhë të gjatë, më të gjatë se edhe vetë periudha e komunizmit, të cilin vazhdojmë ta "bekojmë" a ta mallkojmë. "Mene, tekel, fares" – Çdo gjë ishte "llogaritur, peshuar, ndarë" si s'ka më mirë. Sistemi ia kishte arritur qëllimit – me egërsinë e me djallëzinë më të madhe, kishte shkatërruar gjithçka.

I gjithë ky transformim revolucionar "historik" ishte bërë për të kënaqur fqinjët e Shqipërisë dhe për të siguruar "stabilitetin" politik rajonal; si dhe, për të rregulluar ujditë e të mëdhenjve të

kësaj bote. Një projekt politik makabër që shkonte shumë më tej se ç'dukej në shikim të parë. Shqipëria – kurban. Kurban në luftë, kurban në "paqë", kurban në revolucion, kurban në kundër-revolucion, kurban për luftën, kurban për "paqën"… ballkanike, evropiane e botërore.

Të huajt që vinin në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit, si turistë a vizitorë, si vëzhgues a si spiunë, dëgjonin me flegmatizëm atë çka u thuhej nga shoqëruesit shqiptarë për "mrekullinë shqiptare", nga e cila duhet të mësonte gjithë bota. Të "çuditur", në heshtje e plot mirësjellje, ata bënin sikur miratonin mungesën e pluralizmit politik e partiak, mungesën e demokracisë, të lirive e të drejtave elementare të njeriut etj. dhe mendonin se ky popull mbase kështu e dashka lirinë. Kështu qenkan gatuar; qenka popull i veçantë, i "kënaqur" a i krisur, mbase kështu është mësuar. Qenka nga ata "popuj të mjerë që lavdërohen me robëri," stigmatizon poeti kombëtar turk me origjinë shqiptare Mehmet Akif. Shqipëria – një "De profundis": "Nga thellësitë" vjen jehona e lutjes ose himni që u këndohet të vdekurve gjatë varrimit sipas kanunit të kishës katolike, që do të thotë "këmbana e vdekjes".

Për të huajt, apolitikë a naivë, ajo që nuk e përtypnin dot dhe u dukej e pabesueshme, madje krejt absurde ishte mungesa e lirisë së besimit fetar, heqja e institucioneve fetare dhe e objekteve të kultit, ndalimi i praktikave fetare dhe zhdukja e kishave e xhamive; mohimi i të drejtës për të besuar në Zot e për t'iu lutur Atij. Pas gjithë këtyre mungesave e privacioneve, ky popull të kishte sëpaku një ngushëllim shpirtëror, që ti shërbente si kurë për të qetësuar e mbajtur nën fre shpirtin e paqes a të revoltës. Ata nuk e kuptonin dhe nuk mund të kuptonin se çfarë pune i dilte një regjimi politik me Zotin, që rrin e sheh atje lart në qiell duke i lënë njerëzit në punën e vet pa "ngacmuar" askënd. Gjëja e parë që njeriu ka nevojë në këtë botë është besimi.

Shqipëria socialiste – shteti i parë dhe i vetmi shtet ateist në botë. Gjë e paimagjinueshme, "novacion" çmendurak, një bidat i paparë e i pangjarë në historinë njerëzore. Partia e Punës e Shqipërisë kishte ngritur edhe një "Muze Ateist" në Shkodër, në qendrën e "reaksionit", siç thuhej nën zë e mbi zë; rast unikal në botë. Shërbente si mjet konkretizimi për një "orë të hapur" mësimore, por dhe si mjet për të terrorizuar shqiptarët psikologjikisht. Për të "çuditur" botën, dhe për t'iu dhënë mesazhin atyre që duhej: "Ja, shihni, a nuk jemi në rrugën e duhur të historisë? A nuk jemi të aftë ta përligjim sundimin që na është besuar?". Politikë e koduar. "O Allah kërkoj mbrojtjen tënde nga këto katër gjëra: nga dituria që nuk sjell dobi (nënvizimi im), nga zemra që nuk frikësohet, nga nefsi që nuk ngopet dhe nga duaja që nuk pranohet" (Hadith Sherif).

Izolimi politik, ekonomik e kulturor i vendit ndaj botës ishte politikë e regjimit, politikë shtetërore e diktuar nga jashtë apo e bërë për "qejf" të diktatorit, ndjekur nga shteti shqiptar dhe Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH alias PPSH); një program politik i importuar dhe i imponuar, nga Perëndimi a Lindja, a nga të dyja sëbashku. Me "Lindje" këtu duhet të kemi parasysh "Lindjen Sllavo – Greko – Ortodokse dhe jo Lindjen e Afërt, të Mesme apo të Largët.

Por "izolimi" shpirtëror i shtetasve nga Zoti nga vinte dhe pse? Zoti i kishte dhënë krijesat e tij që ata ta njihnin, t'i luteshin e ta adhuronin e jo ta mohonin Atë, aq më tepër, t'i kthenin shpinën e ta shanin, dhe kështu, jo vetëm të mos përfitonin nga mëshira e Tij, por edhe ta zemëronin Atë. Pse pikërisht shqiptarët duhej të hapnin një "front lufte" me Zotin. (O Allah)! "Udhëzona në rrugë të drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!" (Kur'an, S: 1 – El Fátiha).

Së pari i ndanë e i copëtuan kriminalisht Shqipërinë, trojet shqiptare dhe popullsinë e saj pas disa luftërash genocidiale e të paprovokuara duke u hedhur në shpinë fqinjët agresorë (më 1877-1878 dhe më 1912-1921). E rrënuan në ekstrem si popull e si komb. "Mijëra klithma të pashpresa, gjer në Arsh si nuk shkojnë? / As toka, as qiejt, s'ma ndjejnë shpirtin tek rënkon! / Nën këtë kubé të heshtur, shenjë njeriu s'paska!"[1]. Kësaj lufte i shtuan pastaj edhe luftën me vetveten (Revolucion permanent, luftë civile e luftë klasash me teh të hollë e me maje të mprehtë). "Pa pyet, ç'ndodhi? Bijtë e vet të këtij populli / Iu bënë njëri tjetrit më armiq se të huajt! / - Në fund prapë bëhen vëllezër se ua kërkon gjaku, / - Këtë koha e di"[2].

(Nga libri në dorëshkrim "LEVIZJA PER RIVENDOSJEN E LIRISE SE BESIMIT FETAR NE SHKODER 1989 – 1990")

1. Mehmet Akif Ersoj, Safahat (Fletët), përkthyer nga Mithat Hoxha, "ALSAR", Istanbul, 2000, f. 278.
2. M. Akif, po aty, f. 317.

BEHGJET PACOLLI
(President i Kosovës, shkurt – prill 2011)

"Jam tejet i shqetësuar nga niveli që ka arritur debati për fenë. Pa dashur të minimizoj të drejtën e çdokujt për shprehjen dhe mendimin e vet, ajo që po diskutohet kohët e fundit në studiot televizive lidhur me fenë dhe konvertimet ka kaluar çdo kufi të mirësjelljes kulturës dhe respektit ndaj të tjerëve.

Feja është e lirë dhe e garantuar me Kushtetutë, dhe konvertimi është e drejtë e çdo individi. Por askush nuk ka të drejtë të ofendojë fenë te cilës i ka shërbyer deri dje, se ajo mbetet edhe më tutje feja e të tjerëve.

Është patetike dhe e padrejtë të thuhet se dikush konvertohet sepse Perëndimi nuk po na pranon si muslimanë!!!

Si mysliman praktikues *(familja ime mirëmban për 30 vite Xhaminë në Lugano),* dhe asnjëherë as mua dhe as familjes time të gjerë nuk na ka penguar feja jonë në integrimin dhe bashkëjetesën me popullatat me besime të ndryshme.

Ju lutem, ndaloni këto debate përçarëse që janë bërë të neveritshme.

Le ta duan secili fenë e vet dhe mënyrën që ka zgjedhur për të bashkëjetuar me te por mos te ofendon fenë e të tjerëve!!!"

TAJLANDA
OSE MBRETËRIA E TAJLANDËS

Tajlanda, zyrtarisht Mbretëria e Tajlandës, e njohur historikisht si Siam (emri zyrtar i vendit deri në vitin 1939), është një vend në Azinë Juglindore, në Gadishullin Indokin. Tajlanda kufizohet me Mianmarin në veriperëndim, me Laosin në verilindje dhe lindje, me Kamboxhian në juglindje, me Gjirin e Tajlandës dhe Malajzinë në jug, dhe me detin Andaman në jugperëndim. Ajo gjithashtu ndan kufijë detarë me Vietnamin në juglindje, dhe me Indonezinë dhe Indinë në jugperëndim.

Tajlanda ka një sipërfaqe prej 513,120 km2, dhe një popullsi prej 71,885,799 banorësh (macrotrends.net, 2024).

Bangkoku është qyteti më i madh dhe kryeqyteti i vendit.

GJEOGRAFIA

Tajlanda përbëhet nga disa rajone të veçanta gjeografike. Në veri të vendit gjenden male të larta, ku pika më e lartë është Doi Intanon në vargmalin Tanon Tong Çai. Në verilindje të vendit gjendet rrafshnalta Khorat, kurse në lindje është lumi Mekong. Qendra e vendit dominohet kryesisht nga lugina e sheshtë e lumit Çao Praja, lumë i cili derdhet në Gjirin e Tajlandës.

Tajlanda jugore përbëhet nga rripi i ngushtë tokësor Kra, që kalon nëpër det dhe që zgjerohet në Gadishullin Malajzian.

Lumejtë Çao Praja dhe Mekong me degët e tyre janë shumë të rëndësishëm për prodhimin bujqësor të Tajlandës.

Gjiri i Tajlandës ka një sipërfaqe prej 320,000 km2. Në të derdhen lumenjtë Çao Praja, Mae Klong, Bang Pakong dhe Tapi. Ky gji kontribuon në sektorin e turizmit të Tajlandës, për shkak të ujërave të pastra dhe të cekëta përgjatë brigjeve të rajonit jugor dhe të rripit tokësor Kra. Bregu lindor i Gjirit të Tajlandës është një qendër industriale . Aty gjendet porti kryesor i mbretërisë (në Sattahip) dhe porti i saj tregtar më i ngarkuar (në Laem Çabang).

KLIMA

Tajlanda karakterizohet nga tri stinë: stina e nxehtë (mars-maj), stina e lagësht (maj - tetor), dhe stina e ftohtë (nëntor - shkurt).

Stina e nxehtë është më e dukshme në veri të vendit. Në vende si Çiang Mai, temperaturat mesatare arrijnë në rreth 37oC në prill, me erë minimale dhe relativisht me pak reshje shiu, ndërkohë që në jug, në këtë stinë, temperaturat mesatare arrijnë në rreth 33OC (në Phuket).

Stina e lagësht dominohet nga musoni jugperëndimor, i cili sjell ajër të ngrohtë e të lagësht nga oqeani Indian, dhe që rezulton në shi të bollshëm gjatë këtyre muajve.

Stina e ftohtë sjell një kthesë të konsiderueshme në kushtet e motit, për shkak të musonit verilindor, i cili i ndryshon drejtimet e erës, duke sjellë ajër të ftohtë dhe të thatë, dhe duke rezultuar në temperatura më të ftohta dhe në më pak reshje.

EKONOMIA

Tajlanda është një ekonomi në zhvillim dhe konsiderohet një vend i sapo industrializuar. Para viteve 1960, ekonomia tajlandeze bazohej kryesisht në prodhimin e orizit, ushqimeve dhe mallrave të tjera për konsum të brendshëm edhe për eksport (kryesisht eksportohej oriz, gomë, lëndë drusore dhe kallaj). Më pas qeveria filloi të promovojë një zhvendosje nga bujqësia në prodhimin e tekstileve, mallrave të konsumit dhe, përfundimisht, në prodhimin e komponentëve elektronikë për eksport. Në vitet 1980, Tajlanda kishte hyrë në një rrugë të fortë industrializimi. Kriza ekonomike e fundit të shekullit të 20-të e ngadalësoi, por nuk e ndaloi këtë transformim ekonomik.

Gjatë viteve 1980 - 1990 u shfaqën industri të shumta të orientuara nga eksporti, kryesisht në zonat përreth Bangkokut. Migrimi në shkallë të gjerë i njerëzve nga komunitetet rurale në zonën më të madhe të Bangkokut bënë që krahu i punës në fshat të pakësohej shumë, kështu që ata që vazhdonin të ndiqnin bujqësinë u kthyen gjithnjë e më shumë drejt makinerive për të kompensuar mungesën e punëtorëve, duke sjellë një zhvendosje në ekonominë rurale nga bujqësia për jetesë, në bujqësi të orientuar drejt tregut. Ndër kulturat e prodhuara për treg janë kassava (një lloj rrënje si patate), misri, kenafi (një fibër jutelike), fruti longan, mangoja, ananasi, duriani, shqemet, perimet dhe lulet. Prodhimet si goma, kafeja, kallam sheqeri dhe shumë fruta prodhohen kryesisht në prona të mëdha në pronësi të agrobizneseve që filluan të shfaqen në dekadat e fundit të shekullit të 20-të. Verilindja e vendit karakterizohet nga mabrështimi i bagëtive.

Tajlanda dikur ishte një nga eksportuesit kryesorë të drurëve të fortë, por më vonë janë bërë përpjekje të bashkërenduara për të ruajtur pyjet ekzistuese dhe për t'i zgjeruar rezervat pyjore gjithashtu.

Peshku dhe gjallesat e tjera ujore kanë qenë burimi kryesor i proteinave në dietën e tajlandezëve që nga kohërat e lashta. Ndërsa shpyllëzimi dhe ndotja e përrenjve dhe lumenjve çoi në një rënie të peshqve të egër të ujërave të ëmbla, ka pasur një rritje të dukshme në rritjen e peshqve në pellgje, veçanërisht në Tajlandën verilindore. Që nga vitet 1970, Tajlanda ka qenë një nga eksportuesit kryesorë në botë të karkalecave të detit dhe të peshkut.

Kallaji, i nxjerrë kryesisht në gadishull, ka qenë prej kohësh ndër burimet minerale më të vlefshme të Tajlandës. Minerale të tjera të rëndësishme që nxirren atje janë qymyri (linjit), zinku, gipsi, fluoriti, tungsteni, guri gëlqeror dhe mermeri. Rubini dhe safiri gjenden përgjatë bregut lindor të gadishullit.

Tajlanda ka rezerva të konsiderueshme të gazit natyror në det të hapur dhe burime më pak të bollshme të naftës në tokë. Në fillim të shekullit të 21-të, varësia e Tajlandës nga nafta e importuar dhe gazi natyror për energji u ulën ndjeshëm.

Që nga fundi i viteve 1990, Tajlanda ka qenë një eksportues i dukshëm i automjeteve dhe, së fundmi, i pajisjeve të telekomunikacionit. Ndërsa zhvillimi industrial është përqendruar në Bangkok dhe rreth tij, prodhimi është zgjeruar gjithashtu përgjatë bregut lindor dhe në veri, e veçanërisht në verilindje të Tajlandës.

GJUHA

Gjuha zyrtare e Tajlandës është Tai. Ajo është gjuha kryesore e arsimimit dhe e qeverisë, dhe flitet në të gjithë vendin. Standardi bazohet në dialektin e popullit qendror tajlandez dhe shkruhet në alfabetin tajlandez, një shkrim abugida që evoluoi nga alfabeti Khmer.

Shumica e gjuhëve të folura në Tajlandë i përkasin njërës prej katër familjeve kryesore gjuhësore: Tai (një nënfamilje e gjuhëve Tai-Kadai), Mon-Khmer (një nënfamilje e gjuhëve austroaziatike), austroneziane dhe kino-tibetiane. Për më tepër, anglishtja përdoret gjerësisht në Tajlandë për qëllime komerciale dhe kryesisht zyrtare. Anglishtja është një lëndë shkollore e detyrueshme që nga klasat fillore e tutje, megjithëse vetëm fëmijët që shkojnë përtej këtyre klasave dhe veçanërisht ata që ndjekin shkollat elitare, fitojnë kompetencë të konsiderueshme në këtë gjuhë.

FEJA

Feja më e përhapur në vend është Budizmi Theravada. Myslimanët përbëjnë grupin e dytë më të madh fetar në Tajlandë, duke përfshirë 12% të popullsisë. Islami është i përqendruar kryesisht në provincat më jugore të vendit: Pattani, Jala, Satun, Narathivat dhe një pjesë e Songkhla Çumphon, të cilat banohen kryesisht nga malajzianë që janë myslimanë sunitë. Të krishterët përfaqësojnë 0.45% të popullsisë, kurse popullsia e mbetur përbëhet nga hindu dhe sikë. Në Tajlandë ekziston gjithashtu një komunitet i vogël hebre.

Kushtetuta nuk emërton një fe zyrtare shtetërore dhe parashikon lirinë e fesë dhe atje nuk ka pasur raportime për abuzime shoqërore ose diskriminim bazuar në besimin ose praktikën fetare. Ligji tajlandez njeh zyrtarisht pesë grupe fetare: Budistët, Myslimanët, Brahmin-Hindutë, Sikët dhe të Krishterët.

Kryeqyteti, Bangkoku

HISTORI

Vende arkeologjike në verilindje të Tajlandës përmbajnë dëshmi të kultivimit të orizit dhe derdhjes së bronzit, që datojnë 5000 vjet më parë. Në kohët e hershme, një varg grupesh fisnore e kontrollonin atë që tani e njohim si Tajlandë. Popujt Mon dhe Khmer krijuan mbretëri të fuqishme që përfshinin zona të mëdha në këtë rajon. Këto mbretëri ranë në kontakt me popujt e tjerë të Azisë Jugore dhe përvetësuan idetë e tyre fetare, politike dhe kulturore, si dhe institucionet e tyre dhe këto më vonë ndikuan në zhvillimin e kulturës dhe identitetit kombëtar të Tajlandës.

Populli Tai fillimisht jetoi në Kinën jugperëndimore dhe më pas migroi gjithashtu në pjesën më të madhe të Azisë Juglindore përgjatë shumë shekujve. Hera e parë e përmendjes së ekzistencës së tyre në rajon shënohet në një mbishkrim të shekullit të 12-të të erës sonë, në Angkor Vat, i cili u referohet njerëzve siam ose "njerëzve me ngjyrë kafe të errët" si vasalë të monarkut Khmer dhe kështu Tajlanda u bë e njohur si Siam-i dhe populli i saj u quajtën "siamezë".

Në vitin 1238, një prijës Tai shpalli pavarësinë e tij nga Kmerët dhe krijoi një mbretëri në Sukhotai, në luginën e gjerë të lumit Mae Nam, në zemër të Tajlandës së sotme.

Mbretëria Sukhotai u pasua në shekullin e 14-të nga mbretëria Ajuttaja. Mbretëria Ajuttaja u bë shumë e fuqishme në shekujt 14 dhe 15, aq sa në vitin 1431 arriti të mposhtte mbretërinë Angkor. Mbretëria Ajuttaja pati një sërë konfliktesh me birmanezët përgjatë shekujve. Këto konflikte arritën pikun e tyre në vitin 1767, atëherë kur birmanezët e pushtuan mbretërinë Ajuttaja dhe e shkatërruan plotësisht atë. Pas disa vitesh, dy heronj kombëtarë, Taksin dhe Çakri, e mobilizuan popullin dhe i dëbuan brenda një kohe të shkurtër pushtuesit dhe e ribashkuan vendin nën Dinastinë Çakri. Në vitin 1782, dinastia Çakri themeloi kryeqytetin e saj të ri në Bangkok. Më vonë prijësit Çakri iu dha titulli Rama I dhe ishte mbreti i parë i dinastisë Çakri e cila e ka mbajtur pushtetin deri më sot.

Gjatë shekullit të 19-të, fuqitë evropiane përbënin kërcënimin më të madh për mbijetesën e mbretërisë. Suksesi i Tajlandës në ruajtjen e pavarësisë së vendit (ishte i vetmi vend i Azisë Juglindore që e bëri këtë) ishte pjesërisht rezultat i dëshirës së Britanisë dhe Francës për pasjen një shteti tampon të qëndrueshëm në mes të kolonive të tyre në Burma, Malaja dhe Indokinë. Megjithatë, më domethënëse në ruajtjen e pavarësisë së vendit ishte gatishmëria e monarkëve të Tajlandës, Mongkut (Rama IV, 1851-68) dhe Çulalongkorn-it (Rama V, 1868-1910), për të negociuar hapur me fuqitë evropiane dhe për të miratuar reforma të stilit evropian që modernizuan vendin, dhe kështu ata e fituan këtë status sovran. Sidoqoftë, Siami, siç njihej atëherë, pagoi një çmim të lartë për pavarësinë e tij, duke humbur kontrollin mbi Kamboxhian dhe Laos-in dhe duke ia dhënë ato Francës dhe duke ia dorëzuar Britanisë së Madhe shtetet veriore të Gadishullit Malaj.

Si rezultat i ndërhyrjes evropiane, deri në vitin 1910, Tajlanda kontrollonte vetëm një pjesë të Azisë Juglindore që kishte kontrolluar një shekull më parë. Në dekadat e para të shekullit të njëzetë, sistemi politik, forcat e armatosura dhe ekonomia e Tajlandës pësuan ndryshime drastike. Shumë tajlandez të pasur studiuan jashtë shtetit dhe si rezultat

12

u shfaq një elitë e vogël e arsimuar në perëndim, të cilët tashmë kishin ide më pak tradicionale. Një grusht shteti pa gjak i kryer nga oficerët ushtarakë dhe nëpunësit civilë në vitin 1932, i dha fund monarkisë absolute dhe përuroi epokën kushtetuese të Tajlandës. Në vitin 1949, vendi e ndryshoi emrin nga "Siam" në "Tajlandë".

Që nga ndryshimet e mëdha të vitit 1932, përparimi drejt një sistemi politik të qëndrueshëm dhe demokratik ka qenë i çrregullt. Politika ka qenë e dominuar nga klikat rivale ushtarake të kryesuara nga gjeneralë të fuqishëm. Këto klika kanë shkaktuar grushte shteti të shpeshta dhe kanë zgjatur periudhat e gjendjes ushtarake në vend. Institucionet parlamentare, siç përcaktohen nga katërmbëdhjetë kushtetutat e shkruara midis viteve 1932 dhe 1987 dhe konkurrenca midis politikanëve civilë, në përgjithësi kanë qenë fasada për qeverisjen ushtarake. Sot vendi ka një demokraci të sapolindur, të mbikëqyrur nga ushtria dhe mbreti i ri që sapo ka marrë frenat nga Mbreti Bhumibol Adulyadej, Mbreti i 9-të i Dinastisë Çakri, i cili ishte monarku me periudhën më të gjatë mbretëruese në vend, deri në vdekjen e tij në vitin 2016.

SI ERDHI ISLAMI NË TAJLANDË

Një nga historianët më të njohur që ka folur për praninë e Islamit në Tajlandë është mendimtari bashkëkohor tajlandez princi Kukrit Pramoj, ish-kryeministër i Tajlandës, i cili dëshmon se Islami mbërriti në Tajlandë, në përgjithësi, në epokën e Mbretërisë Sukhotai, d.m.th në shekullin e 13-të të erës sonë.

Megjithatë, thuhet se - në një formë apo në një tjetër - Islami arriti në tokat tajlandeze që në një periudhë të hershme, si në pjesën tjetër të vendeve të Azisë lindore dhe juglindore, dhe përmendet se tregtarët myslimanë arabë dhe persë, ishin ata që futën Islamin në zonat e pranisë aktuale islame në Tajlandë që nga shekulli i katërt hixhri - shekulli i 10-të i erës sonë.

Islami hyri në këtë rajon nëpërmjet dy mënyrave. Ai hyri atje nëpërmjet tregtarëve arabë, të cilët themeluan porte në bregdetin e Mbretërisë Pattani në atë kohë dhe më pas kësaj përhapja e Islamit u zgjerua në pjesën jugore të Tajlandës me vendosjen atje të arabëve dhe integrimin e tyre në popullatën vendase.

Mënyra e dytë përmes së cilës Islami u fut në Tajlandë ishte prezenca e tij në Kinën jugore, në rajonin e Junanit, ku Islami u përhap në një zonë të gjerë dhe kontrollonte zona të mëdha, kështu që hyrja e Islamit në rajonin e Tajlandës përmes këtij aksi ishte aktive.

Përhapja e Islamit përparoi në Tajlandë përmes depërtimit të muslimanëve në vend dhe u përqendrua në pjesë të ndryshme të Tajlandës qendrore dhe veriore.

Myslimanët përbëhen nga gjashtë kombësi kryesore në Tajlandë: arabët, persianët, indianët, kinezët, malajzët dhe tajlandezët. Kombësitë me origjinë malajziane jetojnë në Tajlandën jugore në provincat Pattani, Gala, Stoll, Narathivat dhe Songkhla, rajone të cilat gjenden të vendosura mes Malajzisë dhe Tajlandës. Ata flasin gjuhën malajze dhe deri më tani e shkruajnë atë me alfabetin arab.

Sa i përket atyre me origjinë birmaneze dhe kineze, ata jetojnë në rajonin verior, ndërsa ata me origjinë indiane, pakistaneze, iraniane dhe arabe jetojnë në qendër, dhe çdo grup etnik ka xhaminë dhe imamin e vet.

Myslimanët në Tajlandë kanë shkolla të tyre islame në përputhje me rregullat e shtetit tajlandez, ku planprogrami ligjor është të ruajë identitetin islam të pakicës muslimane dhe kurrikula akademike që u mundësojnë atyre të regjistrohen në universitetet kombëtare tajlandeze. Shkollat islame private janë të përhapura në qytetet tajlandeze me shumicë myslimane, veçanërisht në jug dhe rreth Bangkokut. Numri i shkollave private islame të regjistruara zyrtarisht në Tajlandë është më shumë se 500 dhe ato marrin mbështetje nga qeveria. Atje ka gjithashtu shkolla të lidhura me xhamitë, të cilat quhen shkollat "Tadika" (që është një shkurtim i emrit të tyre origjinal në gjuhën malajze "Tamen Dediqqan Kang", që do të thotë "Kopsht për rritjen e fëmijëve"), në të cilat fëmijët myslimanë mësojnë parimet e fesë islame dhe shkrim e lexim. Organi administrativ i çdo xhamie administron shkollën e saj. Këto shkolla hapen çdo të shtunë dhe të diele të çdo jave, si dhe në ditët e festatve zyrtare për shkollat shtetërore.

Një lloj tjetër shkollash islame në Tajlandë janë "Shkollat e Vjetra Islame" (që ata i quajnë Funduk), në të cilat ndiqet metoda tradicionale e arsimimit. Nxënësit mësojnë atje Kur'anin e Shenjtë dhe shkencat islame në gjuhën malajze ose tajlandeze. Distrikti Janak në provincën Songkhla ka qenë një nga zonat e famshme për këto shkolla, së bashku me provincat Pattani, Jala dhe Narathivat, ku studentët shkojnë atje nga anë të ndryshme të Tajlandës për të studjuar Islamin. Këto shkolla, së bashku me shkollat e tjera private, kanë luajtur një rol vendimtar në ruajtjen e identitetit Islam të fëmijëve myslimanë në Tajlandë. Sot ato zhvillojnë një aktivitet të organizuar të Thirrjes Islame, duke dërguar mësues për të ligjëruar shkencat Islame në xhamitë e fshatrave të ndryshme në vend, veçanërisht në ato të jugut.

Në vitin 1407 hixhri (1987 e.j) në qarkun Gala të Tajlandës u themelua Instituti për Përgatitjen e Dijetarëve Muslimanë. Gjithashtu u themelua Fakulteti i Studimeve Islame, degë e Universitetit Shtetëror Princi Songkhla Nakrin dhe më pas u themeluan Kolegji Islam në Xhala dhe Universiteti Islam "Fatoni" në Pattani.

Përgatiti:
Msc. Arta ujkaj, *teologe*

https://www.metoffice.gov.uk
https://www.bambootravel.co.uk
https://www.britannica.com
https://en.wikipedia.org
https://riyadh.thaiembassy.org
https://www.islamweb.net
https://lylahamdan.com

PESË ZAKONE TË OSMANLLINJVE

- KAFJA DHE UJI

Kur vinte mysafiri, i nxirrnin kafen me ujë. Nëse mysafiri pinte përpara ujin, kjo do të thonte që ishte i uritur dhe duhej ti përgatitej ushqim. Nëse pinte kafen përpara ujit, kjo tregonte se ishte i ngopur.

- TRËNDAFILI I VERDHË DHE TRËNDAFILI I KUQ

Nëse në portë vendosej një trëndafil i verdhë, kjo tregonte se në shtëpi kishte një të sëmurë, kështu që fqinjët dhe kalimtarët, duhet të ishin të kujdesshëm me zhurmat.

Nëse vendosej trëndafil i kuq, kjo tregonte që në shtëpi kishte vajzë të re në moshë për martesë.

E para, njerëzit duhet të ishin të kujdesshëm me fjalorin që përdornin kur kaloni afër asaj shtëpie, e dyta, që mund të vinin për të kërkuar dorën e vajzës.

- ÇEKIÇI I MADH DHE ÇEKIÇI I VOGËL NË PORTË

Tek porta kryesore e shtëpisë vendoseshin dy çekiçë për ti rënë derës. Nëse mysafiri i binte çekiçit të vogël (që kishte zhurmë ndryshe nga ai i madhi), kështu kuptohej që mysafiri ishte grua dhe derën e hapte e zonja e shtëpisë.

Nëse mysafiri i binte çekiçit të madh, kuptohej që mysafiri ishte burrë dhe derën e hapte i zoti i shtëpisë.

- SADEKAJA DHE SHLYERJA E BORXHEVE

Për të mos ngushtuar të pamundurit dhe të varfrit, ata që kishin mundësi, shkonin në dyqanet e lagjeve dhe lanin borxhet e atyre që kishin emrat në fletoren e borxhlinjve të dyqanit. Ata nuk shikonin emrat, vetëm se shlyenin shumën dhe largoheshin.

Kush donte të jepte sadeka, në cepa të lagjeve, ishte guri i sadekasë. Guri kishte një vrimë në mes. Ata që lenin sadeka, fusnin dorën aty dhe lenin atë që kishin mundësi. Po ashtu ai që merrte sadekanë, fuste dorën dhe merrte atë që donte. Askush se kuptonte, se ai që futi dorën, mori apo dha, në mënyrë që të mos prekeshin njerëzit.

- MOSHA 63 VJEÇARE

Nëse dikush e kishte kaluar moshën 63 vjeçare, kur e pyesnin sa vjeç je, ata e kishin për turp të thonin që i kishin kaluar 63 vitet, në respekt të moshës së Profetit Muhamed - Paqja e Allahut qoftë mbi të, prandaj nuk tregonte moshën e tij, por thonte: "Ka kohë që e kam kaluar cakun".

Përshtati në Shqip: **Bledar Myftari**



Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917-1996)

"Është e pamundur ngritja e një shoqërie me mesazh të suksesshëm, nëse pjesëtarët e saj janë injorantë ndaj kësaj bote, të paaftë në këtë jetë.

Punët e mira që kërkohen, duhet t'i bëjë sëpata e druvarit, gjilpëra e rrobaqepësit, lapsi i shkrimtarit, ekspertiza e doktorit, provëza e farmacistit. I bën ato polumbari në det, piloti në qiell, shkencëtari në laborator, ekonomisti në planin e tij.

I bën ato myslimani, i zoti i Mesazhit, kur ai merr përsipër çdo gjë duke i bërë ato mjete për të triumfuar fenë e Zotit dhe për të lartësuar fjalën e Tij!"

ARTIKULLI I MËPOSHTËM NUK ËSHTË PËRGATITUR DUKE PËRDORUR CHAT GPT OSE NDONJË INTELIGJENCË ARTIFICIALE

Omar Sulejman
(Thirrës islam në Perëndim)

Po e filloj me këtë për një arsye, sepse sado qesharake që duket për ta thënë këtë, mund të vijë një moment kur në të vërtetë të ndodhin që njerëzit të përgatisin të gjithë artikujt ose leksionet e tyre me chat GPT.

Po e filloj duke thënë gjithashtu se është e rëndësishme për secilin person që po e lexon, edhe nëse ai/ajo nuk ka përdorur ende asnjë nga mjetet dhe teknologjitë e reja që janë vënë në dispozicion për ne dhe lutemi që Allahu të na lejojë t'i përdorim për përfitime dhe të na lejojë të pakësojmë dëmin e tyre, Allahumme Amin.

Dua të filloj që si muslimanë kemi qenë gjithmonë në gjendje të shohim pozitivisht në gjërat që na rrethojnë, veçanërisht kur ato bëhen gjithnjë e më të pashmangshme. Dijetarët tanë të së shkuarës kanë qenë në linjën e parë të "krijimit të teknologjive" që do të ishin në dobi të njerëzve, qoftë në shkencë apo në mjekësi, apo edhe matematikë apo ndonjë lëmi tjetër.

Ne jemi njerëz, elhamdulilah, që kemi udhëzime nga Profeti ynë (a.s) për çdo gjë, nga mënyra se si e hamë ushqimin tonë deri tek mënyra se si e përdorim tualetin dhe kështu sigurisht që kemi një kornizë etike me të cilën ne u afrohemi gjërave që Allahu (xh.sh) vendos rreth nesh sot.

Dallimi midis një teknologjie mjekësore më precize dhe një teknologjie ushtarake më precize që e bën vrasjen e njerëzve shumë më të lehtë dhe shumë më automatike dhe zakonisht për fat të keq në anën tjetër të saj janë popullata të varfëra myslimane në mënyrë disproporcionale dhe është një tragjedi, nëse është ndonjë jetë e pafajshme apo ndonjë viktimë e pafajshme, ne shohim ndryshimin midis këtyre dy gjërave, një teknologji mjekësore dhe një teknologji ushtarake.

Kur dëgjojnë se: "Allahu e ka mësuar njeriun me laps". "Ai i mësoi njeriut atë që njeriu nuk e dinte".

Muslimanët nuk e trajtuan diturinë me dyshim. Ata e përdorën atë dituri dhe e panë se të gjitha vijnë nga Allahu (xh.sh) dhe falënderuan Allahun (xh.sh) për të me gjuhët e tyre dhe duke përdorur dhe prodhuar atë që ishte e dobishme për njerëzimin.

Sepse në fund të fundit, çdo gjë që mundëson komoditet, do të konsiderohet në thelb e mirë. Çdo gjë që e bën "jetën më të lehtë" do të shihet si e mirë në thelb dhe kështu ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi dhe ky është përparim.

Si e përkufizojmë përparimin nga një këndvështrim laik?

Ne duhet të bëjmë çdo gjë për të cilën bëhemi më të aftë dhe ne e përcaktojmë përparimin tonë si njerëzim, sepse ne tani jemi në gjendje ta bëjmë këtë dhe nuk ishim në gjendje ta bënim më parë. Dhe kështu bëhet për të maksimizuar fitimin, maksimizimin e efikasitetit, maksimizimin e lumturisë dhe përfundimisht ajo që përfundon të ndodhë është, ju eliminoni fuqinë punëtore komplet, Subhanallah! Kush do të mendonte se brenda vetëm disa muajve të këtyre teknologjive, duke u bërë të disponueshme për ne, një 14 vjeç mund të bënte diçka në telefonin e tij dhe të thoshte: më vizualizo këtë, dhe këtë, dhe që do të zëvendësonte një industri të tërë, ose të paktën ekspertë dhe punë të vështirë dhe kreative.

Pra, ju do të keni sindikata të punëtorëve që nuk do kenë çfarë të bëjnë, sepse tani këto teknologji po e bëjnë fuqinë punëtore gjithashtu të parëndësishme.

Dhe kjo është e gjitha në emër të maksimizimit, maksimizimit, maksimizimit, shfrytëzoje sa më shumë, shfrytëzoje sa më shumë, shfrytëzoje sa më shumë.

Dua t'ju kujtoj se Allahu (xh.sh) flet për sëmundjet shpirtërore, që qëndrojnë në themel të të gjitha llojeve të realiteteve në zhvillim.

"El-Hakumu et-tekathur..." (Ju preokupon shtimi...) Ju jeni shkatërruar nga ndjekja e më shumë, më shumë, më shumë. Më shumë, të shkatërron si qenie njerëzore, në nivel individual, dhe shkatërron një shoqëri gjithashtu kur bëhet kërkimi i bollëkut, unë dua më shumë nga kjo, dua më shumë nga ajo, dhe më shumë nuk do të thotë gjithmonë vetëm më shumë para.

Mund të nënkuptojë: Unë dua të bëj më shumë, në sa më pak kohë të jetë e mundur.

Produktiviteti është i mirë, por kur "më shumë" bëhet përkufizim, atëherë ky është një problem.

Dua të bëhet më shumë për mua, me sa më pak përpjekje nga ana ime.

Sigurisht, ne duam t'i përdorim mjetet për përfitim, por çfarë ndodh kur nuk di të bëj më asgjë për veten time, sepse jam fokusuar në prodhimin e më shumë, e më shumë, e më shumë.

Pra, përfundimisht në emër të produktivitetit përfundoni duke eliminuar plotësisht qëllimin e ekzistencës suaj, nëse kjo është gjithçka për të cilën ekzistoni.

Më shumë, më shumë, më shumë... SubhanAllah, ti mendon për zbrazëtinë e njerëzve dhe fjalët se sa të vërteta tingëllojnë... "El-Hakumu et-tekathur..." – je shkatërruar nga kërkimi i bollëkut, nuk je i lumtur, si individë apo shoqëri, pavarësisht nga aftësia jote për të bërë më shumë fitime, në dukje, gëzojnë më shumë, sepse ajo është boshllëk që Allahu ka vendosur ne zemrën tënde, dhe mund ta plotësosh vetëm me besim dhe shërbim ndaj Zotit.

Kur mendon për Profetin (a.s), kur foli për ymetin, ai tha: "Unë nuk i frikësohem varfërisë për ju", nuk i frikësohem mungesës së burimeve për ju, nuk kam frikë nga paaftësia juaj për të ndërmarrë hapin tjetër kur është fjala për prodhimin tuaj, "ajo që kam frikë për ju" është diçka shumë më e madhe se ajo që unë në të vërtetë "kam frikë për ju se burimet bëhen të shumta, se dynjaja të hapë dyert që t'ju shkatërrojë ju si ata që ishin para jush!", sepse edhe nëse Faraoni nuk do të kishte të njëjtat teknologji, Faraoni kishte të njëjtat sëmundje shpirtërore që nxisin shumë nga prodhimi dhe përdorimet tiranike të teknologjisë sot.

Të frenojmë përdorimin tonë të këtyre gjërave dhe të mos biem viktimë e tyre është një rezistencë kulturore ndaj varësisë. Do ta them përsëri, një rezistencë kulturore ndaj varësisë.

Kur mendoni për atë nga një kornizë botërore për të cilën njerëzit do të flasin, a është kjo ideja e qenieve njerëzore të mos bëhen aq të varura nga teknologjia saqë nuk dinë më të kryejnë funksionet bazë?

Sa prej jush mund të mbani mend një numër telefoni gjatë 10 viteve të fundit?

Ju shikoni se çfarë Allahu (xh.sh) dhe Pejgamberi (a.s) na kanë dhënë me një mendësi të orientuar nga ahireti në këtë drejtim. Një rezistencë kulturore ndaj varësisë, kur Pejgamberi (a.s) na mësoi të kërkojmë strehim tek Allahu: "O Allah kërkoj mbrojtje te Ti nga përtacia dhe paaftësia!"

Nuk është gjë e mirë për një muslimani të jetë dembel, është një nga gjërat më të këqija që mund të kesh, përndryshe nuk do të kërkoje strehim tek Allahu (xh.sh) prej saj, pavarësisht se sa të përshtatshme janë gjërat për ty.

"Ne do t'i shkruajmë hapat e tyre!" Kur Pejgamberi (a.s) u tha njerëzve që do të ecin për në xhami: Qëndroni në shtëpitë tuaja dhe ecni për në xhami, Allahu (xh.sh) do të shkruajë çdo hap për ju, nga aty deri për në namazin e xhumasë. Kudo që të keni parkuar dhe sido që të keni ecur deri në xhami.

Pejgamberi (a.s) tha: "Çdo hap që hidhni drejt xhumasë, Allahu (xh.sh) shkruan për ju, një vit agjërimi dhe një vit kijam!". Allahumme pranoje nga secili prej nesh, Allahumme Amin.

Ju duhet të punoni, duhet të vendosni ato gjëra shtesë në mënyrë që të qëndroni të lidhur.

Kur Pejgamberi (a.s) flet për një person që lexon Kur'an dhe lufton dhe Allahu (xh.sh) i jep atyre dy shpërblime teksa luftojnë me çdo shkronjë. Allahu (xh.sh) shkruan dhjetë sevape për çdo shkronjë të vetme që shqiptoni. Përpjekjet tuaja shpërblehen nga Allahu.

Kur Pejgamberi (a.s) thotë: "Shpërblimi është në përputhje me atë se sa përpjekje keni bërë në vështirësi, përpjekje, nuk mund ta kapni atë vetëm me rezultatet.

Kur flasim për tranzicionin e studimeve, nuk më intereson sa inteligjente bëhen këto gjëra, do të kemi gjithmonë "sened", do të kemi gjithmonë zinxhirin mes nesh ku tregojmë nga ky person, nga ai person, nga ai person. Aty ku njerëzit mësojnë përmendësh Kur'anin, sepse Kur'ani duhet të ruhet në zemrat dhe mendjet tona, ku përvetësimi i njohurive bëhet përmes atij transferimi të duhur.

Kur flasim për "AI" dhe robotë, shikojmë video të gjërave që lëvizin nëpër fabrika dhe janë shumë superiore, duken më të larta se qeniet njerëzore. Bota nuk do të përfundojë me robotë. Ne si muslimanë besojmë si Pejgamberi (a.s) na e tregoi, etapat e shpalosjes së ditës së gjykimit dhe ashtu do të vijë siç Allahu (xh.sh) dhe i dërguari tha.

Duke këmbëngulur në drejtësi dhe për asnjë moment nuk besoj se dexhalli është robot, por besoj se do të përdorë të gjitha format e kohës dhe mashtrimit që i ka në dispozicion dhe Allahu (xh.sh) e di se çfarë taktikash mashtrimi do të jenë të disponueshme për të në atë kohë. Nuk besoj se jaxhuxh dhe maxhuxh po prodhohen në Silicon Valley, besoj në ta si Allahu (xh.sh) dhe i Dërguari (a.s) kanë folur për ta.

Kështu jemi ne si muslimanë.

Zoti juaj është i vërtetë! Po mendoja se si ekzistojnë këto vlera të përhershme në Kur'an, madje edhe me fjalë që janë kaq të panjohura për sahabët.

Një nga frikërat më të mëdha për të cilën po flasin me këtë teknologji janë lajmet e rreme.

Ju mund t'i manipuloni zërin njerëzve, mund të merrni fjalë për fjalë një person dhe t'i bëni ata të thonë diçka që nuk po thonë fare dhe kështu aktorët me keqbesim do t'i përdorin këto teknologji për të nxitur më shumë kaos, më shumë trazira. Madje edhe efekti psikologjik, edhe nëse e dini se ajo që po shikoni nuk është reale, por edhe efekti psikologjik i të parit të një personi të besuar duke thënë diçka kaq të tmerrshme nga shikimi i imazheve dhe videove të bashkuara, ju gërryen psikologjikisht, emocionalisht dhe shpirtërisht. Dhe ti mendon se çfarë është edhe sot mashtrimi që ekziston, industria e lajmeve të rreme jashtë komunitetit mysliman dhe brenda saj, vënia e imazheve jashtë kontekstit, fjalët jashtë kontekstit, bashkimi i videove dhe fjalëve që të mund të krijoni gjëra.

Çfarë thotë Allahu (xh.sh)? Verifikoni informacionin tuaj. Shkoni te burimi. Gjithmonë shkoni te burimi. Sepse përndryshe ju mund të lëndoni dikë pa e ditur dhe më pas do të përfundoni duke u penduar për atë që keni bërë. Kthimi te burimi, pra mosbesimi tek teknologjitë apo informacioni siç lind, duke shkuar te burimi i atij informacioni dhe verifikimi i tij.

Përktheu nga anglishtja:
Gledian Gojashi

MYFTIU PRITI FAMILJARË TË DIJETARIT, SHEJKH NASURIDIN EL-ALBANI

Ditën e enjte, më 1 gusht 2024, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt z. Mohamad Mynir Anamali Adem, i shoqëruar nga i biri, Ilias Mohamad Adem, familjarë të dijetarit dhe hadithologut të shquar, Shejkh Muhamed Nasuridin El-Albani (1914 – 1999).

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu theksoi se kontributi i shqiptarëve në Siri, sidomos në shekullin e kaluar dhe në vijim, është i dukshëm, gjë për të cilën dëshmojnë edhe libra të shumtë të shkruar rreth kontributit të tyre, por edhe gjurmët konkrete dhe emri i mirë, që aranutët (shqiptarët) kanë edhe sot e kësaj dite në Siri, ku jetojnë në disa prej qyteteve siriane.

Myftiu theksoi se fatmirësisht i përket atij brezi thirrësish islamë, që kanë studiuar dhe janë diplomuar në Damask të Sirisë, ku edhe kanë emigruar shumë prej familjeve muslimane shkodrane, në mesin e të cilave edhe familja e Shejkh Nasuridin El-Albanit, familja e Shejkh Sulejman Gavoçit, etj.

Gjatë këtij bashkëbisedimi të ngrohtë u fol edhe për historikun e hoxhallarëve shkodranë dhe kontributin e tyre në lëmi të ndryshme të shkencave islame.

Z. Mohamad Mynir Anamali Adem tregoi edhe disa detaje nga jeta dhe vepra e axhës së tij, hadithologut të shquar, Muhamed Nasuridin El-Albani, lidhjes së tij pas dijes dhe përkushtimit të madh ndaj saj.

Bashkëbisedimi u shoqërua me detaje dhe kujtime të ndryshme nga jeta e dijetarit El-Albani dhe hoxhallarëve të tjerë të shquar të Shkodrës ndër shekuj.

NJË GRUP STUDENTËSH ITALIANË VIZITOJNË XHAMINË E PARRUCËS

Ditën xhuma, më 2 gusht 2024, një grup studentësh italianë, të shoqëruar nga Dom Emilio Valente, vizituan xhaminë e Parrucës.

Në pritje të tyre, imami i xhamisë së Parrucës, H. Naim Drijaj i uroi mirëseardhjen dhe zhvilloi me ta një bashkëbisedim plot vlerë, ku mbizotëroi fryma e harmonisë, dialogut dhe komunikimit të lirë.

Imami i nderuar dëgjoi pyetjet e ndryshme të studentëve rreth Islamit, xhamisë, adhurimeve islame etj, të cilave iu përgjigj me plot kompetencë, duke dhënë informacionet e duhura përkatëse, plot dobi e interes.

Viteve të fundit, përherë e më shumë po shtohet numri i vizitorëve të huaj që vijnë në xhamitë tona, duke shfaqur interesim e duke marrë mikpritjen dhe dashamirësinë e mikpritësit.

MYFTIU PRITI NJË GRUP STUDENTËSH NË UNIVERSITETIN ISLAM TË MEDINES SË NDRIÇUAR

Paraditën e së enjtes, më 8 gusht 2024, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt një grup studentësh nga Shkodra dhe Malësia e Madhe, që vijojnë studimet islame në Universitetin Islam të Medines së Ndriçuar, në Arabinë Saudite.

Gjatë takimit, Myftiu u interesua për gjendjen e studentëve, kushtet dhe arritjet e tyre në këtë rrugëtim të begatë.

Myftiu iu drejtua studentëve tanë me disa këshilla, për shfrytëzimin e kohës, për respektimin e vendit ku vijojnë shkollimin dhe forcimin e vëllazërisë e bashkëpunimit.

Bashkëbisedimi u përqendrua edhe tek gjurmët e hoxhallarëve tanë ndër shekuj dhe përgjegjësia e ruajtjes së kësaj trashëgimie, që na lidh me të Dërguarin e Allahut dhe amanetin e përhapjes së Thirrjes Islame në shoqëri.

PROMOVOHET LIBRI: "HADITHI: TRASHËGIMIA E PROFETIT MUHAMED" I STUDIUESIT DR. JONATHAN AC BROWN

Ditën e diel, më 18 gusht 2024, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Qendrën "Minber" dhe Konak Institute organizoi aktivitetin me temë: "Qasje bashkëkohore ndaj traditës profetike".

Ky aktivitet, në qendër të së cilit ishte promovimi i librit: "Hadithi: trashëgimia e Profetit Muhamed", me autor studiuesin e mirënjohur amerikan, Dr. Jonathan Ac Brown, i përkthyer nga studiuesi Rezart Beka, mblodhi një grup imamësh, teologësh dhe thirrësish islamë, që ndoqën me shumë kënaqësi e vëmendje ligjërimin e autorit.

Aktiviteti pati në qendër diskutimin e autorit të librit, studiuesit Dr. Jonathan Ac Brown, i cili vjen për herë të parë në Shqipëri, falë kontributit të Konak Istitute dhe studiuesit Besnik Sinani.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Dr. Ferid Piku, drejtor i Qendrës Studimore "Minber", që u bë shkak për këtë aktivitet elitar.

Në emër të Myftinisë Shkodër, aktivitetin e drejtoi dhe e përshëndeti teologu Ervil Kuçi, përgjegjës i sektorit të rinisë, pranë Myftinisë Shkodër.

Në fund të takimit për të pranishmit, autori pati kënaqësinë të dhurojë librin e tij, së bashku me autografin dhe përshëndetjet e rastit.

5 IMAMË E TEOLOGË NGA SHKODRA, PJESË E TRAJNIMIT TË UBDM NË STAMBOLL

Nga data 26-31 gusht 2024, në Stamboll u zhvillua një trajnim shkencor me pjesëmarrjen e disa imamëve nga Ballkani, organizuar nga Unioni Botëror i Dijetarëve Muslimanë me seli në Doha të Katarit në bashkëpunim me institucionin e Dijetarëve Muslimanë të Turqisë (UMAD).

Ky trajnim me promotor dhe organizator prof. dr. Hajredin Hoxha, mblodhi rreth 40 imamë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriu, Mali i Zi dhe Presheva.

Nga Myftinia e Shkodrës ishin përzgjedhur H. Arben Halluni, H. Lavdrim Hamja, H. Durim Kasemi, H. Sadri Ujka dhe H. Ademir Xama.

Në programin e trajnimit u prezantuan objektivat dhe synimet që ka Unioni Botëror i Dijetarëve Myslimanë, ruajtja e frymës institucionale dhe respektimi i udhëheqësit fetar, bashkëjetesa dhe paqja sociale si dhe shumë tema të jetës bashkëkohore.

Kryetari i Unionit Botëror të Dijetarëve Myslimanë, prof. dr. Ali Karadagi, mbajti ligjëratën rreth konceptit të veçantë që ka ndërtuar me dekada jurisprudenca ekuilibruese (Fikhu El Mizan), e për të cilën tha se ka qenë tejet e nevojshme, ngase keqkuptimet dhe keqinterpretimet e teksteve fetare kanë qenë tejet të pranishme në mesin e besimtarëve.

Një kumtesë interesante ishte edhe ajo e prof. dr. Muhamed Ali Salabit, i cili njëherësh është edhe zëvendëskryetar i Unionit. Ai gjatë ligjërimit të tij theks të veçantë i kushtoi Kur'anit, si burimi dhe referenca më e besueshme e dokumentimit të historisë njerëzore dhe jo vetëm.

Gjatë këtij trajnimi përmes dijetarëve prof. dr. Isam El-Beshir, prof. dr. Abdul Vehab Akinçi, prof. dr, Refet El-Mikati (rektor i Universitetit Islam në Bejrut), prof. dr. Hajredin Hoxha, prof. dr. Safvet Haliloviç etj, imamët pjesëmarrës patën mundësi të dëgjojnë referate të ndryshme nga Kur'ani, tefsiri, fikhu, kultura dhe civilizimi, si dhe për kontributin e shqiptarëve myslimanë në komentimin e Kur'anit Famëlartë.

Në fund të trajnimit me vlerë, në prani të Kryetarit i Unionit Botëror të Dijetarëve Myslimanë, prof. dr. Ali Karadagi, u mbajt ceremonia e mbylljes me shpërndarjen e certifikatave si dhe u zhvilluan vizita në disa xhami kryesore dhe monumentale të Stambollit.

Pejgamberit (a.s) ka thënë:

"Ëshillohuni me njëri-tjetrin në dituri, sepse tradhtia e ndonjërit prej jush në dituri, është më e rëndë sesa tradhtia e tij në pasuri dhe Allahu do t'ju pyesë për të!"

(Transmetuar nga Tabaraniu në "El-Kebir")

MEJTEPI IM... XHAMIA OMARAJ, POSTRIBË

Pak histori:

- Xhamia e fshatit Omaraj ndodhet në një zonë të thellë të Njësinë Administrative Postribë, Bashkia Shkodër.

- Aktualisht, Omaraj është 100 % mysliman dhe përbëhet me rreth 70 familje (aktualisht jetojmë më pak se gjysma e saj për shkak të emigrimit).

- Fiset më të njohura janë: Bushaj, Dushaj dhe Ndrejaj.

- Xhamia e rikonstruktuar në vitin 1993 dhe pas vitit 2000 është mbi themelet e xhamisë së vjetër 175 vjeçare.

- Imamët e xhamisë Omaraj dhe njëkohësisht edhe mësues të mejtepeve që kanë shërbyer nga viti 2002 dhe në vazhdim janë: Kujtim Cufaj, Berhan Bilani, Festim Hysaj dhe imami aktual, Fatmir Bushaj

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 18 mejtepe dhe kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në periudha të ndryshme nga viti 2002-2024 është rreth 450 nxënës.

Takimi me nxënësit:

Ditën e xhuma, më 23 gusht 2024, teologu Arben Halluni, përgjegjës i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, fillimisht drejtoi ritet e xhumasë në xhaminë Omaraj.

Teologu Halluni gjatë mesazhit të hytbes së xhumasë u ndal te rëndësia dhe ruajtja e familjes sipas traditës islame, që është një aspekt themelor i jetës shoqërore dhe morale. Ai bërë thirrje që familja të konsolidohet më shumë se kurrë si bërthamë e vërtetë e shoqërisë dhe të mos lejohet në asnjë situatë që të tjetërsohet apo të venitet përmes shpopullimit dhe braktisjes së vendit, për të cilën jemi të ngarkuar nga Zoti Madhniplotë ta ruajmë dhe ta zhvillojmë sipas kodeve të natyrshme dhe hyjnore.

Në vijim, pas faljes së xhumasë, drejtuesi i arsimit zhvilloi një takim me nxënësit e mejtepit të xhamisë Omaraj, që zhvillohet nën kujdesin e imamit të përkushtuar, H. Fatmir Bushaj.

Në fillim, teologu Halluni zhvilloi një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin: si përçimin te brezi i ri i mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor, etj.

Takimi dhe vizita në Omaraj u mbyll me pyetje-përgjigje, bisedë me xhematin për mbarëvajtjen e jetës fetare në këtë zonë dhe me një koktejl të organizuar enkas për nxënësit e mejtepit.

ترحب بضيوف شكودرا الكرام، إخواننا و أحبابنا من دول الخليج!

أهلاً و سهلاً بكم، نورتم مدينة شكودرا!

www.myftinia-shkoder.org

@Myftiniashkoder1990

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek